



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400 - 6819

Drenas, me 12.06 2013

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë me datën 11.06.2013 miratoi këtë;

**VENDIM PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN
2013**

Neni 1.

Me këtë vendim miratohet, rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2013.

Neni 2.

Buxhetit i Komunës për vitin 2013 është analizuar dhe rishikuar në të gjitha programet dhe nënprogramet buxhetore, por ndryshimet në buxhet janë bërë të këto programe-nënprograme sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve:

Pagat dhe Mëditjet zbritën:

- të Zyra e Kryetarit në shumë prej: 4,800,00 €.
- të Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi në shumë prej: 3,766,00 € dhe
- të Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik në shumë prej: 2,400.00€

Pagat dhe Mëditjet rritën:

- të Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emërgjencë në shumë prej: 2,400.00€ dhe
- të Drejtorati për Arsim në shuma prej: 8,566.00€

Mallra-shërbime zbritën:

- të Qendra për Punë Sociale në shumë prej: 2,000.00€ dhe
- të Qendren e Mjekësisë Familjare në shumë prej: 10,000.00€.

Mallra-shërbime rritën:

- të Drejtorati për Inspeksion në shumë prej: 10,000.00 €. Kjo shumë e mjeteve transferohet nga Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi nga projekti: "Inqizimi i rrugëve në Komunën e Drenasit", nr i projektit: 87019.